



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 09 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 28.12.2018, të investitorit Bujar Dugolli nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës së banimit, me etazhitet B+P+1, në rrugën “Shyqri Kushevisa”, Lagjja “Sofalia” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me datën 21.01.2019, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit** pronarit Bujar Dugolli nga Prishtina, sipas kërkesës 09 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 28.12.2018, për përdorimin e ndërtesës me destinim banim individual, me etazhitet B+P+1, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale nr. P-71914066-00155-1, Zona Kadastrale Sofali, sipas Vendimit 05 nr.351-4595 dt. 15.02.2012 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

**II.** Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-4595 dt. 15.02.2012, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Komisionit profesional të pranimit teknik, të emëruar sipas vendimit nr. 05 Nr.351/04-0243950/18 dt.22.10.2018 nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

**III.** Ndërtesa e banimit individual mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

**IV.** Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrat kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Investitori **Bujar Dugolli nga Prishtina**, më kërkesën me 09 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 28.12.2018, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën e banimit individual, me etazhitet B+P+1, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Raportin Kontrollimit teknik të Komisionit profesional.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Dëshmi se të gjitha pagesat janë bërë,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të kontrollit teknik të ndërtesës për banim individual, ka konstatuar se:

Në raportin e kontrollit teknik të komisionit profesional për pranimin teknik të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se gjatë realizimit të ndërtesës janë realizuar disa ndryshime vetëm në funksion të ndërtesës, ndërsa në gabarit nuk ka pasur asnjë ndryshim. Ndryshimet në brendësi të ndërtesës, janë të aspektit funksional, ndërsa është ruajtur koncepti i përgjithshëm arkitektonik, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa administrative mund të përdoret. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë respektuar.

**Kërkesat e Vendimit 05 Nr.351-4595 të datës 15.02.2012 janë zbatuar,**

**Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,**

**Masat për kursim të energjisë janë ndërmarre.**

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me etazhitet B+P+1, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.


**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj Drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-0303379/18 DT. 21.01.2019**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit:


Lindita Beqiri



Drejtori:

Ardian Qlluri





Në bazë të nenit 157 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03, dt. 21.06.2016, nenit 96, 97, 98 dhe 99 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28, dt. 22.07.2005, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në detyrë zyrtare, me datë 21.03.2018, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR KORRIGJIMIN E CERTIFIKATËS SË PËRDORMIT 05 NR. 391/02-0303379/18 DT.**  
**21.01.2019**

**I. Korrigjohet** gabimi teknik në Vendimin 05 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 21.01.2019, lëshuar nga kjo drejtori, në emër të Bujar Dugolli nga Prishtina, për pajisje me certifikatë të përdorimit për ndërtesën me destinim banim individual me etazhitet B+P+1 e ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale me numër P-71914066-00155-1, Zona Kadastrale Sofali sipas Vendimit 05 Nr. 351-4595 dt.15.02.2010 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

Korrigjimi i gabimit teknik bëhet në pjesën tekstuale të tij, përkatësisht në pjesën e arsytimit, ku në vend të “*ndërtesa shumë banesore me afarizëm*” duhet të jetë “*ndërtesa e banimit individual*”

**II.** Ky Vendim do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit 05 Nr. 391/02-0303379/19 dt. 21.01.2019, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

**A r s y e t i m**

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me Vendimin 05 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 21.01.2019, ka pajisur me Certifikatë të përdorimit Bujar Dugollin nga Prishtina, për ndërtesën me destinim banim individual me etazhitet B+P+1 e ndërtuar në kuadër të ngastrës kadastrale me numër P-71914066-00155-1, Zona Kadastrale Sofali sipas Vendimit 05 Nr. 351-4595 dt.15.02.2010 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

Në ndërkohë, kjo drejtori, në procedurë të publikimit ne web të kësaj Certificate, ka konstatuar se në pjesën përfundimtare të aktit administrativ “Certificate e përdorimit”, 05 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 21.01.2019, është përvjedhur një gabim teknik, përkatësisht është shënuar gabim emërtimi i ndërtesës, dhe atë në vend të “*ndërtesa e banimit individual*” është shënuar “*ndërtesa shumë banesore me afarizëm*”.

Andaj, pas kontrollimit dhe verifikimit të të njëjtit, është vërtetuar se, duke u bazuar në rregullativën ligjore, duhet të bëhet korrigjimi i gabimit teknik, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

**I dërgohet:** Kërkuesit, Drejtorisë së Inspeksionit, Drejtorisë së Kadastrit, kësaj Drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe vendoset në dosjen e lëndës 05 Nr. 391/02-0303379/18 dt. 21.02.2019.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 Nr. 391/05-0303379/18 DT. 21.03.2019**

Zyrtari,  
Berim Osmanaj



U.d. Udhëheqëse e sektorit,  
Lindita Beqiri

